



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI"
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI"
Prizren



Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+383 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. i ref. 01-_____

Prizren, me: ___/___/_____

Bazuar në dispozitat e nenit 16 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 , si dhe vendimin e Këshillit Drejtues, Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, shpall:

KONKURS
PËR PUNË PRAKTIKE PËR STUDENTËT E UUHP-SË

Ftohen të gjithë kandidatët që i plotësojnë kriteret e mëposhtme që të aplikojnë për punë praktike në administratën e Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.

Puna praktike ka si objekt që t'ju ofrojë studentëve mundësi që dijen teorike të nxënë gjatë studimeve, ta aplikojnë në praktikë, duke krijuar përvojë të punës në administratë, si staf mbështetës në njësitë administrative të UUHP-së.

Numri i pozitave: 10 praktikantë.

Kohëzgjatja e punës praktike : 3 muaj

Kriteret për përzgjedhjen e studentëve për punë praktike:

- Kandidatët për punë praktike duhet të kenë të përfunduar studimet e nivelit baçelor në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren" ose të paktën student në vitin e dytë të studimeve në UUHP.
- Në përzgjedhjen e studentëve për punë praktike, komisioni do të marrë parasysh notën mesatare të studentëve.
- Praktikanti/ja preferohet të ketë: Shkathtësi të komunikimit; aftësi të mira analitike, Shkathtësi dhe njohuri në aplikimin e programeve kompjuterike nga pako Microsoft Office dhe shkathtësi në punë teknike; Aftësi të punës në grupe.
- Të mos ketë punuar më parë në punë praktike në UUHP.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim dhe mënyra e aplikimit

Kandidatët me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

1. Kërkesën për shprehje interesi,
2. CV-në,
3. Certifikatën e notave,
4. Kopjen e diplomës, certifikatës së diplomës ose certifikatën e notave për studentët aktual.
5. Kopjen e letërnjoftimit.

Konkursi mbetet i hapur 10 ditë.

- Data për aplikim është nga 21.02.2019 deri më 04.03.2019 në ora 16:00.
- Shpallja e listës me kandidatët e përzgjedhur nga komisioni ad hoc do të bëhet me datën 05.03.2019 në faqen zyrtare të Universitetit.
- Studentët e përzgjedhur për punë praktike, do të nënshkruajnë kontratën e angazhimit me Universitetin.
- Dokumentet duhen të dorëzohen në formatin elektronik pdf në e-mail adresën: apliko.upz@uni-prizren.com.
- Studentët do të jenë të angazhuar me orar të plotë sipas rregullores 05/2010 (08:00-16:00)
- Praktika për studentët e përzgjedhur do të zgjasë tre muaj (3 muaj), në periudhën mars-maj 2019.

Kandidatët që nuk pranohen kanë të drejtë ankese në afat prej 3 ditësh në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave që funksionon në kuadër të administratës së Universitetit.

Inkurajohen që të aplikojnë të gjithë studentët e UUHP-së pa kurrfarë dallimi, respektivisht të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Praktikantët në përfundim të punës praktike do të pajisen nga Universiteti "Ukshin Hoti" me: Referencë dhe Certifikatë.

Burim Berisha
Sekretari i Përgjithshëm